

MJEDISI SOT

**Të bukura,
jo vetëm për t'u parë...**

Bimët ofrojnë burimet gjenetike në shërbim të jetës

faqe 11



**Burimet Gjenetike
Bimore në Shqipëri**

faqe 18



**Fitorja e Obamas
shënon rilindjen e
politikës amerikane
për mjedisin**

Numër 123 | 2008

MJEDISI SOT

është një botim periodik i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Zyra në Shqipëri

Në këtë botim të përmuajshëm do të gjeni informacion për probleme mjedisore, lajme të përzgjedhura, opinione e komente për çështje të mjedisit nga vendi dhe rajoni, informacione për aktivitete për mjedisin nga vendi dhe bota etj.

Versionin elektronik të kësaj reviste mund ta gjeni në faqet: <http://albania.rec.org> dhe www.mjedisisot.info

Për të marrë "Mjedisi Sot", e përditshme elektronike, me postë elektronike apo revistën "MJEDISI SOT" (botim periodik), dërgoni emrin dhe adresën tuaj pranë REC Shqipëri, në adresat:

Kutia Postare 127, Tiranë;
Tel/Faks: (04) 23 29 28;
ose info@albania.rec.org



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT Shqipëri

është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Europën Qendrore e Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

REC është krijuar në 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni Europian dhe Hungaria. Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e REC, nënshkruar nga 29 vende dhe Komisioni Europian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 17 vendeve përfutuese, të cilat janë: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, RIJ e Maqedonisë, Polonia, Rumania, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia.

Donatorët më të fundit janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Shqipërisë, Austrisë, Belgjikës, Bosnje-Hercegovinës, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Japonisë, Letonisë, Lituanisë, RIJ të Maqedonisë, Hollandës, Norvegjisë, Polonisë, Serbi-Malit të Zi, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.

EDITORIAL

3

Bankat në krizë, po ato gjenetike a janë „zgjidhja“?

NGA VENDI

3-4

Poliçan, asgjësohen 113 kg lëndë të rrezikshme

Fier, alarm për ndotjen akustike

Panorama 2008

Politikat e investimeve në mospërputhje me zhvillimin e qëndrueshëm

TEC - Zhvillim apo aferë karboni?!!!

NGA REC

6-7, 17

Era e ndryshimit: edukimi mjedisor – (r)evolucioni që po ndodh

Mbështetja nga REC në kuadër të Fondit Special Holandez 2 (Viti 2008)

Zhvillimi i kapaciteteve - Njoftimi për Trajnim

AKTUALITET

8-9

Për herë të parë në ballkan një grup i gjelbër lobues

Monitorimi i NO2 në qytetin e Tiranës

TEMA E NUMRIT

10-16

Burimet Gjenetike Bimore në Shqipëri

UBT: Kapacitete dhe përvojë e rigjallëruar

Banka gjenetike e Shqipërisë pjesë e SESTO

**Bashkëpunimi institucional,
si çelës suksesi për ruajtjen e vlerave natyrore**

Burimet gjenetike bimore-pasuri kombëtare

Aktivitete të Projektit SEEDNet (2008)

Projekti SEEDNet

NGA BOTA

18-19

Fitorja e Obama-s shënon rilindjen e politikës amerikane për mjedisin

**Krijohet një Agjenci Ndërkombëtare
për Energjinë e Ripërtëritshme (IRENA)**

Një pamje e re e ndryshimeve klimatike nga Google Earth



Ky numër është mundësuar nga projekti SEEDNet

Kanë kontribuar për këtë numër:

Alban Ibraliu • Fatos Harizaj • Ndoc
Faslia • Tatjana Dishnica • ECAT
Tirana • Qendra EDEN • Alken
Myftiu • Genta Hoxha

Stafi Editorial

Mihallaq Qirjo • Alken Myftiu
• Genta Hoxha • Eduart Cani •
Daniela Ruçi



Foto ilustrative nga Paketa e Gjelbër

Editorial

Bankat në krizë, po ato gjenetike a janë „zgjidhja“?

Me krizën ekonomike që po kalon globi, muajt e fundit janë bërë makth jo vetëm i financierëve dhe politikëbërësve të gjithë botës, duke mbajtur sytë drejt tabelave elektronike të bursave. Kohë pas kohe, qeveritë e shumë vendeve miratojnë injektime kolosale fondesh drejt sistemit financiar, por kriza nuk duket të jetë një sëmundje e lehtë.

Krahas përballjes së pasojave të krizës ekonomike, një nga sfidat më të rëndësishme të njerëzimit, mbetet ruajtja e vlerave dhe burimeve natyrore. Burimet gjenetike përbëjnë një vlerë të padiskutueshme dhe bazën për vazhdimësinë e jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm në planetin tonë. Deri më tash kemi parë jo pak filma të Holivudit, të tipit fantastiko-shkencor ku subjekti është vendosur në të ardhmen dhe lufton të mbijetojë ndaj krizave jo më ekonomike, por atyre gjenetike! Megjithatë, kriza e sotme financiare, disi e befte në shpërthimin e saj pas një periudhe „lulëzimi“ ekonomik, tregon se asgjë nuk mund të jetë më aq e largët.

Me gjithë rëndësinë jetike, kjo pasuri përballet me rreziqe, sidomos ata antropogjenë që po shkaktojnë një “erozioni gjenetik” gati të pakontrolluar. Rritja me ritme të shpejta e popullsisë, në kushtet ku burimet natyrore janë të pandryshueshme, ka sjellë një shkatërrim të vazhdueshëm të ekosistemeve natyrore (hapja e tokave të reja, prerja e pyjeve, industrializimi etj.). Kjo dukuri globale ka sjellë zvogëlimin e larmisë biologjike brenda llojeve dhe zhdukjen e llojeve të veçanta në zona të ndryshme të planetit.

Në kushtet e një erozioni të tillë të larmisë biologjike, nevoja e ruajtjes së burimeve gjenetike të bimëve ka bërë që, në shumë vende të botës, të ngrihen banka të fuqishme për ruajtjen afatgjatë të materialit gjenetike, zakonisht në formën e farave. Pak kush di se Shqipëria ka një Bankë Gjenetike, pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), që zotëron një pjesë të pasurisë bimore të vendit të grumbulluar në vite, në bashkëpunim dhe falë kontributit të ish-institucioneve të ndryshme kërkimore të bujqësisë dhe aktorë të tjerë.

Çdo ditë që kalon është një vlerë e humbur; është një mundësi reale për zhdukjen e një varieteti autokton, të një bime të rrallë apo të një popullate të një lloji të caktuar.

Çdo ditë që kalon është një sinjal i negativ për të ardhmen e njerëzimit, e cila po rrezikohet duke humbur shansin që t'i lerë një pjesë të trashëgimisë së sotme, brezave të ardhshëm.

Zgjidhja e krizës ekonomike e ditëve të sotme duket më e thjeshtë se sa përballja me atë gjenetike që mund të mos jetë larg.

Polican, asgjësohen 113 kg lëndë të rrezikshme

Plot 113 kilogram lëndë të rrezikshme të mbetura nga ish-Uzina e Armëve në qytetin e Poliçanit janë asgjësuar përfundimisht gjatë dhjetorit.

Megjithë kundërshtitë e shfaqura hapur nga kryebashkiaku Adriatik Zotkaj në lidhje me rrezikun që paraqet eliminimi i tyre për jetën e banorëve, sigurimin e pronës dhe ndotjen e mjedisit, autoritetet më të larta të ushtrisë përqendruan të gjithë vëmendjen në Poliçan.

Drejtori i uzinës, Myqerem Xhaferri pohon se plani është detajuar menjëherë pas përfundimit të të gjithave procedurave ligjore për zhvillimin e tij.

Një pjesë e banorëve që jetojnë me afër uzinës, u evakuuan me qëllim shmangien e rreziqeve.

Shpërthimet e realizuara me anë të djegies me shpërthim, përbënin mënyrën më të mirë dhe efikase për eliminimin e sasisë së lëndëve të rrezikshme.

Fier, alarm për ndotjen akustike

Banorët e qytetit të Fierit po vuajnë nga ndotja akustike, e cila është në shifra alarmante. Më të shqetësuar janë ata që jetojnë në lagjet industriale të tij, pasi zhurmat e forta janë të përditshme. Për këtë situatë banorët shpeshherë janë ankuar pranë pushtetit vendor dhe prefekturës, por asgjë nuk ka ndryshuar.

Shumë banorë shprehen se asnjëherë nuk kanë kuptuar se kush e shton më tepër zhurmën, makinat apo punishtet e firmat private. Drejtoresha e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Angelina Mertiri, mbështet ankesën e banorëve, por thotë se duhet një ndërgjegjësimit mbarëqytetar që do të sjellë qetësimin e situatës.

Panorama 2008



Ministria e Mjedisit

Në daljen publike të gati fund-vitit, me rastin e takimit "Mbrotjtja e mjedisit dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri" organizuar prej IDR dhe Co-Plan, Ministri i Mjedisit Xhuveli paraqiti disa nga arritjet e punës së institucionit të tij. Ekspozeja mbuloi periudhën gati 4 vjeçare të qeverisjes demokratike duke theksuar nevojën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik të vendit dhe proceset e integritimit europian.

Z. Xhuveli theksoi se prioritet ka qenë plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor mjedisor. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 75 ligje dhe 27 akte nënligjore dhe janë në proces edhe 15 projekt ligje e vendime të Këshillit të Ministrave. Deri më tani Shqipëria është palë në 23 konventa e protokolle mjedisore. Sipërfaqja e zonave të mbrojtura është rritur nga 5,4% në vitin 2005, në 12,8 në vitin 2008 me zgjerimin e Parkut Kombëtar të Butrinit, Malit të Dajtit i dhe shpalljen e zonave të reja të mbrojtura si ai i Shebenikut.

Ndonëse ecuria e mirë e plotësimit të kuadrit ligjor, nuk ndiqet nga po i njëjti progres në zbatimin e tyre. E gjykuar si një ndër pikat e dobta, zbatimi i ligjit mbetet ende dimension i ku forca e shtetit është shpesh e pandijshme. Gjatë 2007-2008 janë vendosur gjoba për 228 subjekte dhe 108 aktivitete industriale, dhe janë pezulluar rreth 87 aktivitete të ndryshme.

Sipas kësaj Ministrie, cilësia e ajrit, si ndër çështjet më problematike për qendrat më të populluara, monitorohet në 7 qytete të vendit me 15 stacione të ndryshme. Rritja e shkallës së investimeve nga bizneset si për shembull investimi me 19,5 milion Eur në Elbasan nga Kurum do të mundësojë kapjen e 95% të grimcave dhe rezultojë në përmirësimin real të cilësisë së ajrit. Nga ana tjetër, synohet kontrolli i shfrytëzimit të shtartit të lumejve duke e kufizuar kohën e shfrytëzimit vetëm në 5 muaj dhe në një gjatësi të përgjithshme prej 50 km. Njëkohësisht, përmes kufizimit të lejeve mjedisore, numri i subjekteve do të ulet nga 106 në 76 të tilla.

Në vijim të nxitjes së nismave të biznesit dhe investimeve në vend, Ministria e Mjedisit do të shohë mundësinë e lehtësimit të procedurave duke shkurtuar kohën e dhënies së lejeve mjedisore në 5 javë apo të autorizimeve në vetëm 2 javë.

Ngjarje mjedisore

18 Janar - Miratohet ndërtimi i fabrikës së cimentos në Krujë

27 Janar - Përkujtohet 85 vjetori i Shërbimit Pyjor Shqiptar

29 Janar - OJF-të dalin me një deklaratë për shtyp lidhur me ngritjen e impiantit të prodhimit të energjisë nga era në zonën e Karaburunit

7 Shkurt - Prespa dhe Ohri zgjidhen nga revistat presitigjoze "Forbes" dhe "Lonley Planet" në listën e 20 destinacioneve më të bukura europiane

15 Mars - Shpërthen depoja e çmontimit të municioneve në Gërdec

10 Prill - Shqipëria aderon në Konventën ndërkombëtare për kontrollin dhe administrimin e ujërave të balasteve dhe sedimenteve të anijeve

23 Prill - Miratohet studimi "Zhvillimi i integruar i zonës energetike dhe industriale të Porto-Romanos" në Durrës, ku parashikohen të ndërtohen dy TEC-e dhe një rafineri për naftën

24 Prill - Banka Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Ndërtim (IBRD) i akordon Qeverisë së Shqipërisë dhe Malit të Zi një grant prej 4.55 milionë dollarë për Projektin e Menaxhimit të Integruar të Ekosistemit të liqenit të Shkodrës

14 Qershor - Festohet Dita e Liqenit të Shkodrës në kuadër të projektit "Bashkëpunimi Ndërkufitar mes Vendeve që ndajnë Burime Natyrore të Përbashkëta"

2 Korrik - Nënshkruhet kredia me Bankën Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar, për financimin e projektit të kanalizimeve për Tiranën e madhe, në vlerën 66.2 milionë euro

2 Korrik - Miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.994, "Për Tërheqjen e Publikut në Vendimmarrje për Mjedisin"

9 Korrik - Organizata Botërore e Monumenteve UNESCO pranon Beratin në Listën e Pasurive Botërore të Monumenteve

1 Shtator - Durrësi merr presidencën e 55 bashkive të Adriatikut dhe Jonit

18 Shtator - Banorët e fshatrave Kimzë dhe Kalivar, në komunën Gjegan të Pukës, padisin në gjykatë, firmën turke që ka me koncesion minierën e bakrit në Kimzë, për ndotje të mjedisit

17 Tetor - Enti Rregullator i Energjisë Elektrike miraton kërkesën e një kompanie private për të ndërtuar dy centrale të prodhimit të energjisë elektrike nga era në parqet e Llogorasë dhe Karaburunit

19 Nëntor - Qeveria shtyn afatin e përdorimit të naftës D2 deri në fund të dhjetorit 2009

2 Dhjetor - Kryeministri italian, Silvio Berlusconi, dhe ai shqiptar, Sali Berisha, nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e parkut energjistik në Jug të vendit.

3 Dhjetor - Përfundon faza e parë e projektit të bankës gjermane KfW për pastrimin e Liqenit të Pogradecit nga ujërat e zeza

Politikat e investimeve në mospërputhje me zhvillimin e qëndrueshëm

51 përfaqësues të shoqatave mjedisore të Shqipërisë, të mbledhur më datën 14 dhjetor 2008 në takimin vjetor të tyre, shprehin publikisht dhe me shqetësim të madh se politikat e investimeve në vitet e fundit në vend, sidomos në energjitikë, nuk janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm, gjë që do të shkaktojë pasoja social-ekonomike dhe kundërshtu me politikat mjedisore të Bashkimit Europian.

Deri më tani, janë miratuar dhe janë drejt firmosjes së kontratës përfundimtare: i) TEC-i me biokarburant 150 MW në zonën e mbrojtur, të projektuar midis lagunës së Knallës dhe Merxharit; ii) Terminali për transportimin e cimentos në Shëngjin; iii) Fabrika e cimentos me kapacitet rreth 1 milion ton në Balldre të Lezhës; iv) Super TEC-i me qymyr në Porto Romano me kapacitete të instaluar që deformojnë totalisht balancën e sistemit tonë të pastër energjetik; v) Terminali i rigazifikimit të gazit të lëngët në Seman të Fierit me kapacitet 12 miliard m³; vi) Parku eolik i Karaburunit, më i madhi në Europë, me kapacitet 500 MW, i cili është projektuar të ndërtohet në një zonë të mbrojtur, dhe pjesërisht në parkun kombëtar të Llogorasë, duke mos respektuar as pronën e vendasve në Karaburun; vii) Naftësjellësi AMBO

me terminalin e tij në gjë të Vlorës me kapacitet 1 milion fuçi në ditë.

Për të shmangur vendimmarrjet e shpejtuara dhe për të rritur përgjegjësinë në këto vendimmarrje me rëndësi të madhe kombëtare dhe ndikim të fortë në mjedis, shoqatat mjedisore kërkojnë: 1) Të pezullohet nënshkrimi i kontratave të veprave të klasifikuara me ndikim të shkallës së lartë në mjedis, përfshirë veprat e sipërpërmendura, gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të qeverisë aktuale, si dhe ligjvënësit ta konsiderojnë këtë si çështje për t'u konvertuar në ligj; 2) Të gjitha veprat e lartpërmendura t'i nënshtrohen një diskutimi të gjerë me publikun, diskutim deri tani thuajse tërësisht i munguar; 3) Të kryhen vlerësime strategjike mjedisore në Lezhë, Krujë, Durrës, Fier e Vlorë, detyrim ky ligjor deri tani plotësisht i pazbatuar.



Gurore në Balldre/Lezhë - Foto E. Gani

Për më shumë rreth takimit, kontaktoni me:

Milieukontakt International; <milieuka@icc-al.org>

TEC - Zhvillim apo aferë karboni?!?!

Pjesë nga artikulli i Qendra EDEN në bashkëpunim me CEE Bankwatch Network

Historia e TEC-it të Durrësit është e shkurtër, e dyshimtë dhe e lidhur ngushtë me zhvillimin e parqeve të energjisë dhe industrisë në Shqipëri. Në 3 Dhjetor 2007, Ministri shqiptar i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Drejtori Ekzekutiv i ENEL, Fulvio Conti, firmosën një memorandum për zhvillimin e sektorit energjetik në Shqipëri. Sipas këtij memorandum, kompania italiane mori përsipër të ngrejë një TEC me qymyr prej 1300MW dhe ndërtimin e një rrjeti lidhës fuqie me Italinë në një lokalitet të panjohur.

Në nëntor 2008, këshilli rajonal i rregullimit të territorit në Durrës aprovoi ndërtimin e parkut energjetik, në një sipërfaqe prej 810 ha në Porto Romano, i promovuar nga Ministria shqiptare e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Rregullimit të Territorit dhe qeverisë shqiptare janë ende pezull.

Përgjithësisht, termocentralet me qymyrguri kanë faktorin më të lartë të

emetimit për njësi energjie të krijuar, që vjen nga eficienta e ulët operationale dhe përmbajtja e lartë e karbonit në qymyr. Në kuadër të shkarkimeve të përgjithshme të CO₂ në Shqipëri, (rreth 3,6 milion ton në 2003), kapaciteti marramendës i centralit të Durrësit do të kontribuojë në rritjen e emetimeve të vendit.

Në këndvështrimin e marrëveshjes së re për ndryshimet klimatike, që do të zëvendësojë Protokollin ekzistues të Kiotos pas 2012, Shqipëria do të ketë detyrime për zbatimin e masave për uljen e shkarkimeve të karbonit, dhe sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe stimulues për teknologjitë me përdorim të ulët të karbonit. Vendimi i fundit për ndërtimin e termocentralit me qymyr për 30 vitet e ardhshme mund të influencojë ndjeshëm pozitën e Shqipërisë në lidhje me shkarkimet e karbonit.

Me gjithë faktin që termocentralet me qymyr njihen si ndikuesit më të mëdhenj në ndryshimet klimatike dhe me gjithë rregullat e rrepta mjedisore të

tregut në BE, elita qeveritare shqiptare duket të jetë e vendosur për ta pasur një të tillë. Pyetja shtrohet nëse kjo vendosmëri vjen si rezultat i vlerësimit strategjik të prodhimit dhe eficientës së energjisë në vend, vlerësimit të teknologjive të termocentraleve dhe shqyrtimit të përgjegjshëm të shkarkimeve të karbonit nga Shqipëri në terma afatgjatë?

Procesi skizofrenik i vendimmarrjes për termocentralin me qymyr të Durrësit i realizuar deri tani nuk e tregon këtë!


Sa për ENEL-in, prodhimi i energjisë në një vend jo-anëtar të BE-së, ku reforma e BE për skemën e tregtimit të shkarkimeve të karbonit mungon dhe, për rrjedhojë, prodhimi i energjisë nga qymyri nuk bëhet shumë i shtrenjtë, është katërcipërisht fitimprurës. ENEL-i, në këtë mënyrë, mënjanon kostot shtesë të shkaktuara nga kjo reformë dhe, në të njëjtën kohë, plotëson kërkesat për energji në vend (Itali). Kostot e ndotjes sigurisht që nuk do t'u mbeten italianëve për t'i paguar!

**Përshatja për shtyp
Anisa Xhitoni**



Mbështetja nga REC në kuadër të Fondit Special Holandez 2 (Viti 2008)

▼ Nr. i Grantit	▼ Titulli i grantit	▼ OJF/vendi i zbatimit	▼ Shuma e akorduar
TF2-001	Përmirësimi i mjedisit ne qytetin e Krrabës përmes ndërtimit të kanalizimeve dhe rrethimit të vendgrumbullimit të mbetjeve	Shoqata “Eko-ALB-I/Krrabë	1,711,424 lekë
TF2-002	Rikualifikimi mjedisor i zonës midis Unazës së re dhe blloqeve të pallateve “Liri Gero” dhe “8 Shkurti” nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare	Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit/Fier	4,555,360 lekë
TF2-005	Mbrojtja e shtëpive nga përmbytja ne lagjen Uznovë, Berat dhe përmirësimi i mjedisit urban	“Instituti për Mjedisin dhe Zhvillimin Rural”/Berat	1,507,968 lekë
TF2-011	Sistemimi dhe rrethimi i vend-depozitimit të mbeturinave të ngurta në bashkinë Manëz	Shoqata Mbrojtja dhe zhvillimi mjedisor & social ILIRIA/Manëz	4,188,800 lekë
TF2 -031	Parku natyror i Dumresë	Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunalë / Dumre	1.712.000 Lekë
TF2 -036	Ndërtimi i një prite mbi lumin e Zhepovës për të parandaluar përmbytjet në komunën e Sukës Përmet.	Forumi i Bujqësisë dhe Blegtorisë Përmet / Përmet	1.274.000 Lekë
TF2 -039	Së bashku për një qytet të shëndetshëm	Shoqata “ Qendra Kombëtare për Shërbime Komunale”/Patos	1.439.000 Lekë
TF2 -045	Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjen Skënderbej, Elbasan	Për një Shqipëri të Shëndetshme / Elbasan	4.188.800 Lekë
TF2 -046	Përmirësim i kushteve të jetesës për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme “28 Nëntori” Burrel	Shoqata “ Instituti për ruajtjen e natyrës Shqipëri” / Burrel	3.399.000 Lekë
TF2 -047	Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në qytetin e Ballshit	Shoqata “Qendra e Studimeve dhe Konsultimeve për Përdorimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore – Q.S.K.Natyra” / Ballsh	3.920.000 Lekë
TF2 -054	Investimet e reja industriale në Shqipëri, Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në procesin e informimit dhe vendimmarrjes	Qendra e Grupimit “EkoLëvizja” / Tiranë	577.000 Lekë
TF2 -066	Sistemimi dhe gjelbërimi i hapësirës publike në lagjen “Holta”	Shoqata ambientaliste “Gramshi” / Gramsh	3.100.000 Lekë
TF2 -072	Shpallja Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit si Rezervë Biosfere – sfida për komunitetin vendor	Shoqata “Gruaja Intelktuale – Pogradec” / Pogradec	570.000 Lekë
TF2 -077	Mjedis më i pastër – Individë dhe komunitete më të shëndetshme	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike; / Balldren, Lezhë	590.000 Lekë
TF2 -083	Monitorimi i vendimmarrjes dhe zbatimit të vendimeve që lidhen me infrastrukturën urbane në zonën e Liqenit Artificial të Tiranës dhe rrugët për përmirësimin e tyre	Shoqata “ G&G grup” / Tiranë	592.000 Lekë





Nga trainimet për Paketën e Gjelbër - Foto D. Ruçi

Era e ndryshimit: edukimi mjedisor – (r)evolucioni që po ndodh

Mihallaq Qirjo, REC

Ndër vitet e tranzicionit, në emër të problemeve të shumta, i kemi dhënë të drejtë faktit që për së pari të mendojmë për gjërat më parësore të jetës. Kjo është e vërtetë sidomos në Shqipëri ku ende mendohet “për vezën sot, sesa pulën nesër!”. Nuk do t’i referohem zhvillimit

“...Përdorimi i Paketës së Gjelbër e ka bërë më të thjeshtë kuptimin dhe shtimin e njohurive mbi mjedisin. Kjo paketë dhe ne mësuesve na ka ndihmuar së tepërmi për një mësimdhënie sa më korrekte dhe frytdhënëse...”

**Shpëtim Hadaj,
Mësues, Malinat, Berat.**

ekonomik të vendit, për të cilin ky proverb i popullit do të shkonte më mirë. Le të shohim një tjetër drejtim. Një ndër dimensionet më të rëndësishme të çdo familjeje është edukimi i fëmijëve. Cili është i zoti të argumentojë se

matematika apo leximi, edukimi fizik apo muzika janë më të rëndësishme se sa edukimi për mjedisin? Edukimi i sotëm fëmijëve bëhet për të krijuar një brez të aftë të drejtë dhe çojë përpara shoqërinë e nesërme, të paktën atë shoqëri që do t’i takojë 15-25 viteve të ardhshme. E meqë kjo është e pashmangshme, na bëhet edhe më e vështirë vendimmarrja se cilat lëndë apo kurrikula janë më të rëndësishme sot për fëmijën 10 vjeçar!

Edukimi mjedisor shpesh shihet si zgjidhje e problemeve të së tashmes. Për shembull, edukimi më i mirë i fëmijëve do të ndihmojë shoqërinë të ndërgjegjësohet më shumë mbi mbajtjen pastër të mjediseve të përbashkëta apo krijimit të sjelljeve më të përgjegjshme konsumatore. Ndonëse kjo është e vërtetë, më shumë punë edukuese dhe detyruese duhet bërë me ne të rriturit.

Le tu kthehemi sërish më të vegjëlve dhe thelbit të edukimit mjedisor. Edukimi i tyre përmban jo vetëm

përgjegjësinë e formëzimit të tyre pro mjedisor, por edhe ndryshimit që brezi ynë duhet të kryejë sot si mësues e formatorë të tyre. Mjedisi i dëmtuar përreth nesh dhe burimet e shterrshme të planetit po konturojnë një botë gjithnjë e më konkurruese dhe të egër, me çmime në rritje dhe më shumë njerëz që zhyten në varfërinë dhe ditë-netët plot përpjekje për një jetë qoftë edhe modeste. Pak apo aspak mendojmë sot që prodhimi dhe konsumi të na plotësojë nevojat tona dhe jo të na ushqejë egon personale për të gjetur lumturinë tek shpenzimi i tepruar dhe harxhimi material.

Mësuesit tanë të arsimit bazë renditen ndër mbi 15,000 mësuesit e shumë vendeve të Evropës, të cilëve më së fundi u është shtuar edhe Maqedonia, të cilët japin “Paketën e Gjelbër”. Ata përcjellim njohuritë, aftësitë dhe mesazhet edukuese për mjedisin, që po zë më shumë vend në diskutimin dhe veprimin e përditshëm. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, në bashkëpunim me Institutin e Kurikulës dhe Trajnimit (IKT) vijon me dhënien e trajnimeve të avancuara për edukimin mjedisor në të gjitha Drejtoritë Arsimore Rajonale. Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2008 janë organizuar trajnime me mësuesit e shkollave 9 vjeçare të Lezhës, Kavajës dhe Tiranës. Deri në fund të këtij viti shkollor, REC do të zhvillojë rreth 20 trajnime të këtij niveli. Vazhdimësia e trajnimit të mësuesve, jo vetëm për informacionin mjedisor, por dhe metodologjitë e edukimit mjedisor ka një rëndësi parësore në garantimin e qëndrueshmërisë së edukimit mjedisor të nxënësve në shkollë. Gjatë dy viteve të fundit statusi i zbatimit të kësaj pakete në shkolla të ndryshme ka variuar nga lëndë me zgjedhje, në lëndë kros-kurrikulare apo veprimtari ekstra-kurrikulare.

Për herë të parë në Ballkan një grup i gjelbër lobues

Trajtimi i problemeve për një zhvillim të qëndrueshëm urban, si dhe një mbrojtje të suksesshme të mjedisit, kërkon një zhvillim dhe zbatim të integruar të politikave në nivel lokal, kombëtar dhe në atë rajonal.

Kjo mbledhi së bashku në një tryezë të rrumbullakët pune, deputetë të Parlamenteve të Maqedonisë, Shqipërisë, si dhe shoqërinë civile, në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të zbatimit të projektit “Themelimi i të parit Grup të hapur Lobues në Ballkan”. Në këtë takim merrnin pjesë deputetë të partive të ndryshme politike nga të dy vendet fqinje. Aty u fol gjerësisht për problemet që shqetësojnë sot dy vendet tona, si edhe për këtë mënyrë të re bashkëpunimi, midis politikëbërësve dhe shoqërisë civile.

Në takim u theksua se bashkëpunimi ndërmjet vendeve tona është shumë i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian. Nga të pranishmit u konstatua se edukimi, në tërësi, i komunitetit dhe, në veçanti, ai mjedisor është thelbësor për sja i përket disiplinimit të situatës aktuale mjedisore në të dy vendet tona.

Gjithashtu, u konstatua se duhet edhe një sensibilizim edhe më i madh me pushtetin vendor në zonat kufitare, dhe jo vetëm në Tiranë.

Organizatorët e takimit, ishin 4x4x4 Balkan Bridge Tirana në bashkëpunim të ngushtë me 4x4x4 Balkan Bridge Shkup, duke u mbështetur edhe nga partnerët e tjerë në projekt si Qendra e Gjelbërt Maqedonase (Shkup) dhe Koalicioni për Zhvillim të Qëndrueshëm (Shkup).

Projekti po përdor përvojën pozitive të përfutuar nga themelimi i Grupit të Gjelbër Lobues (Green Lobby Group) në Parlamentin Maqedonas, e cila do të kthehet në një trampolinë për themelimin e Grupit të Gjelbër Lobues Rajonal, dhe eventualisht Balkan Green Lobby Group.



Aktiviteti i grupit - Foto e projektit

Kjo nismë mundësohet përmes një granti të dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Europën Qendrore e Juglindore, Programi SECTOR, financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA).

Eneida Mara

Shoqata “4x4x4 balkan bridges” <eneida@4x4x4bb.org>

SONDAZH I MJEDISI SOT

417 Votues

Çfarë masash keni marrë për ta bërë konsumin e energjisë në shtëpinë tuaj më eficient?

- Përdorimi i pajisjeve me eficiencë të lartë energjie **17%**
- Termoizolimi i mjediseve të brendshme **16%**
- Përdorimi i paneleve diellore **20%**
- Fikja e dritave dhe pajisjeve pas përdorimit **46%**



Matës të cilësisë së ajrit në një nga pikat e përcaktuara - Foto ECAT

Monitorimi i NO₂ në qytetin e Tiranës

■ Ndotja në qytetin e Tiranës mbetet një problematikë gjithnjë e hapur. Elementët e ndryshëm të ndotjes, që shkaktohen nga trafiku i dendur dhe punimet e vazhdueshme në qytet, paraqesin rreziqe të ndryshme për jetën e banorëve. Me gjithë përmirësimet e dukshme në infrastrukturë dhe masat që janë marrë për përmirësimin e cilësisë së karburanteve dhe largimin e automjeteve me efikasitet të dobët të përpunimit të karburantit, Tirana përsëri renditet në listën e qyteteve me probleme të ndotjes nga elementë kimikë me rrezikshmëri të lartë.

Pikërisht, vlerësimi i këtyre ndotësve u bë dhe fokusi i një fushate monitorimi nga ECAT Tirana, në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit të Venetos (ARPAV), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Pyjeve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi u organizua në periudhën 27-31 Tetor 2008, një fushatë monitorimi të NO₂ me tuba pasivë në qytetin e Tiranës. Në këtë fushatë morën pjesë dhe studentë të Fakultetit të Inxhinierisë së Mjedisit. Fushata synonte përcaktim të përqendrimit të dioksidit të azotit (një nga derivatet e shkarkimeve në ajër të automjeteve) si dhe hartëzimin i përqendrimeve të NO₂ në gjithë qytetin e Tiranës, që pritet të shërbejë si një bazë e rëndësishme për vendim-marrësit në menaxhimin e cilësisë së ajrit, dhe si një mjet i domosdoshëm për t'u përdorur në vlerësimin e efekteve të ndotjes së ajrit në shëndetin publik si dhe të përfitimeve të mundshme të veprimeve që duhen të ndërmerren për të ulur ndotjen e ajrit,

Fushata e monitorimit të NO₂ me tuba pasivë në qytetin e Tiranës u zhvillua në kuadrin e projektit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Trafikut në Qytetin e Tiranës",

financuar nga Programi LIFE i BE dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit të Gjermanisë.

Grupi i punës i përbërë nga ekspertë të Agjencisë Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit të Rajonit të Venetos, Itali, si dhe ekspertë lokalë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e Pyjeve, ECAT Tirana, Instituti i Mjedisit dhe Energjisë, përcaktuan, së pari, rreth 35 pika ku do të vendoseshin kampionatorët e tubave pasive, duke përdorur metodën e përzgjedhjes rastësore, sipas një rrjete gjeometrike mbi hartën e Tiranës me akse perpendikulare. Në këtë mënyrë u lokalizuan vendndodhjet të orientuara nga trafiku i automjeteve: a) vende me trafik të dendur, b) vende me trafik mesatar dhe c) vende me trafik të ulët. Gjithashtu, u vendosën tuba difuzivë

dhe në zonën e gjelbër të qytetit të Tiranës (Parku i Tiranës), duke patur në këtë mënyrë një përfaqësim të plotë të realitetit urban për sa i përket ndotjes së ajrit të shkaktuar nga trafiku i automjeteve. Tubat difuzivë Radiello për përcaktimin e përqendrimit të NO₂ si dhe të BTX-eve (benzen, toluen, ksilen, etc.) u instaluan në këto 35 pika dhe u ekspozuan për një periudhë 10 ditore. Tubat difuzivë u vendosën dhe në vendet ku janë instaluar stacionet automatike të monitorimit të cilësisë së ajrit. Në disa vende, tubat difuzivë u vendosën të dubluara për të bërë krahasimin e të dhënave të marra nga laboratorit i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Pyjeve dhe nga laboratorit i Agjencisë Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit të Venetos (ARPAV).

Nga të dhënat paraprake të dërguara rezultoi se nga 35 zonat ku u vendosën tubat difuzive, 12 zona rezultuan me një përqendrim të lartë mbi normat e lejuara të NO₂ sipas direktivës të BE.

Këto zona përfaqësojnë kryqëzimet e rrugëve kryesore që karakterizohen nga një trafik i dendur. Si më problematike vlen të përmenden zonat te kryqëzimi i 21 Dhjetorit, në kryqëzimin e "Rrugës së Durrësit" me "Rrugës Ded Gjon Luli", në kryqëzimin e Bulevardit "Zogu i Parë" me unazën, te tregu i Perimeve në Rr. "Ferit Xhajko", Bulevardi "Zhan Dark", Sheshi "Sulejman Pasha", kryqëzimi i Rr. "Qemal Stafa" me Rr. "Bardhyl".

Procesi vijon me modelimin dhe hartografimin e përqendrimeve të NO₂ në qytetin e Tiranës, të cilat do të mund të ndërtojnë një panoramë më të qartë mbi rrezikun në të cilin përballen çdo ditë qytetarët e Tiranës, por jo vetëm ata.

ECAT Tirana
Rr. Abdyl Frashëri, Pall.6, Shk.6, Ap.53, Tiranë



“Natyre e qetë” shqiptare...
...traditë dhe shije

Burimet Gjenetike Bimore në Shqipëri

■ Si zakonisht, për pasuritë dhe vlerat natyrore, Shqipëria përsëri renditet ndër vendet e para në Europë, kësaj rradhe për vlerat e saj të shumta të bimësisë së egër dhe asaj të kultivuar. Natyrisht që meritat më të shumta për këtë i takojnë karakteristikave natyrore e gjeografike të vendit dhe vlerave të shumta që përban flora e vendit tonë.

Kjo pasuri kombëtare duhet ruajtur dhe përdorur me shumë kujdes dhe, realisht, duhet të trajtohet si pjesë e trashëgimisë sonë biokulturore, e krijuar gjatë shekujve. Aktualisht, kësaj pasurie i kanoset një rrezik potencial, dukuria e “erozionit gjenetik”. Kjo dukuri globale, përditë e më shumë, po bëhet më e theksuar, duke sjellë ngushtimin e biodiversitetit dhe madje dhe zhdukjen e llojeve të veçanta në rajone të caktuara të planetit. Shkaku kryesor, që ka sjelle këtë “erozion”, është faktori antropogjen (njeriu).

Rritja me ritme të shpejta e popullsisë, në kushtet kur potencialet e burimeve natyrore janë të pandryshueshme, ka sjelle një shkatërrim të vazhdueshëm të ekosistemeve natyrore (hapja e tokave të reja, prerja e pyjeve, industrializimi etj). Dhe kur vjen fjala për Shqipërinë, përveç këtyre proceseve të sipërpërmendura, njerëzit kanë ushtruar një presion gjithnjë e më rritje ndaj natyrës, sidomos në këto 20 vitet e fundit, nëpërmjet të ashtuquajturave masa për zhvillim, që shpeshherë rezultojnë në shkatërrim të burimeve natyrore për disa përfitime të momentit.

Tek bimët e kultivuara, dëmi më i madh është kryer gjatë proceseve të zhvillimit të bujqësisë, duke zëvendësuar popullatat lokale të bimëve me kultivare dhe hibride me kapacitet të larta prodhimi.

Banka Gjenetike dhe në Shqipëri

Në kushtet e një erozioni të tillë të biodiversitetit, para më shumë se tre dekadash, u themelua me mbështetjen

Kjo pasuri e ka burimin në :

- Variacioni i lartë i relievit
- Kushte të favorshme klimatike duke filluar nga subtropikalja deri në atë kontinentale më në thellësi
- Pozicioni gjeografik në pellgun e Mesdheut dhe në Ballkan
- Lloje të ndryshme të shtresave gjeologjike dhe tokësore
- Flora e Shqipërisë
- Shqipëria ka florë shumë të pasur me rreth 3250 lloje bimore ose rreth 30% të florës së Evropës
- Brenda kësaj flore ekziston një grup i veçantë i rreth 30 llojeve endemike dhe rreth 180 lloje subendemike
- Vlerë të veçantë për Florën tonë kanë dhe llojet e rralla e të kërcënuara, llojet relikte, etj.

e FAO “Rrjeti Ndërkombëtar i Instituteve të Burimeve Gjenetike të Bimëve” “IPGRI”, i cili jep kontributin kryesor në koordinimin e politikave që lidhen me problemet e resurseve gjenetike të bimëve

Nevoja e ruajtjes së burimeve gjenetike ka bërë që në 30 vende të botës të ngrihen banka të fuqishme ndërkombëtare të materialeve gjenetike, zakonisht në forme të farave që zenë pak hapësirë dhe që ruhen për periudha nga disa deri në disa dhjetra vjet.

Bankat gjenetike po marrin zhvillim të madh në botë, veçanërisht në kushtet e një erozioni gjenetik të vërejtur në kushtet e ndryshimeve klimatike në zona të ndryshme.

Në këto kushte, për të bërë më eficiente punën e bankës, lind nevoja për të patur një bazë të dhënash informatike të sigurt.

Në Shqipëri, fillesat e saj Banka Gjenetike e Shqipërisë i ka në vitin 1998, si një kontribut i qeverisë amerikane, shprehur në bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë nga Universiteti i Misisipit dhe organizmave si USAID dhe IFDC, sektor pjesë përbërëse e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, Ministria e Bujqësisë.

Kuptimin e vërtetë si institucion, Banka e mori në vitin 2001, me ligjin Nr. 8732 “Për materialin mbjellës bimor” dhe Udhëzimin Nr. 107 të MBUMK,

ku specifikohet si institucion i mirëfilltë shkencor me rëndësi kombëtare, që grumbullon dhe ruan fondin gjenetik bimor të vendit...”

Sot, banka gjenetike ruan një pasuri bimore të grumbulluar në vite, në bashkëpunim dhe falë kontributit të ish- institucioneve të ndryshme kërkimore të vendit dhe aktorëve të tjerë.

Koleksioni (i farërave) përbëhet prej rreth 2506 aksesionesh të kulturave të ndryshme në drithëra; perime; foragjere; bimë industriale; bimë aromatike e mjekësore. Ky koleksion, që përfaqëson 44 gjini dhe 62 lloje të ndryshme, përbën koleksionin bazë të bankës gjenetike.

Koleksionimi i Burimeve Gjenetike Bimore në Shqipëri

Misionet dhe ekspeditat e para të koleksionimit, në Shqipëri, kanë filluar para Luftës së Dytë Botërore. Gjatë pushtimit gjerman, janë koleksionuar një pjesë e popullatave autoktone të misrit dhe elbit në disa rajone të Shqipërisë, të cilat ruhen edhe sot në Bankën Gjenetike të Gatersleben, Gjermani.

Misionet e koleksionimit të drejtuar nga Prof. Përmeti në vitet 70. Profesor Hammer (Banka Gjenetike e Gatersleben), së bashku me kërkues nga UBT, Instituti i germoplazmës së Barit kryehen një sërë ekspeditash pas viteve 90 (1993-1994).



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Foto internet

VKM nr. 515, datë 19.7.2006 “Për Ristrukturimin e Instituteve Kërkimore-Shkencore në varësi të MBUMK-së”, përcaktoi Bankën Gjenetike të Shqipërisë, si qendër shkencore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ndërkohë Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktoi rolin koordinues të universiteteve në kërkimin shkencor në Shqipëri dhe, në veçanti, rolin e Universitetit Bujqësor në fushën e burimeve gjenetike të bimëve.

Pas kësaj faze, UBT mori nismën ligjore për të koordinuar aktorët potencialë të fushës së burimeve gjenetike të bimëve në Shqipëri.

Vlen të përmendet bashkëpunimi i frytshëm me MBUMK, me Koordinatorin Kombëtar për Resurset gjenetike, bashkëpunim i cili është finalizuar me një Marrëveshje Institucionale midis UBT dhe MBUMK në fushën e burimeve gjenetike të bimëve.

Kjo marrëveshje përcaktoi qartë si institucionin përgjegjës dhe koordinues për burimet gjenetike të bimëve Bankën Gjenetike, institucion në varësinë e UBT.

Një mbështetje të konsideru-eshme për këtë nismë institucionale të UBT, ka ofruar dhe Projekti SEEDNet, financuar nga SIDA. Mbështetja e SEEDNet, në fushën e burimeve gjenetike të bimëve në Shqipëri, është e bazuar në objektiva të qarta shumëvjeçare.

Kjo mbështetje e SEEDNet e gjithanshme: në drejtim të krijimit të Rrjetit Kombëtar të Institucioneve përgjegjëse për burimet gjenetike të bimëve, për misionet e grumbullimit dhe konservimit të PGR, etj. është e rëndësishme për UBT dhe për vendin në përgjithësi.

Mbështetja financiare dhe logjistike e projektit SEEDNet dhe, në veçanti, e znj. Eva Thorn, koordinatore e projektit SEEDNet, ka bërë që Banka Gjenetike e Shqipërisë të ketë një progres të dukshëm në koordinimin institucional dhe qartësimin e objektivave të saj për të ardhmen.

UBT: Kapacitete dhe përvojë e rigjallëruar

Prof. Fatos Harizaj
Rektor i UBT

■ Shqipëria është një vend i pasur me burime gjenetike të bimëve, ndërkohë që, gjatë dekadave të fundit, problemet e ruajtjes së burimeve gjenetike të bimëve ka qenë një nga pikat më delikate dhe më të rëndësishme për menaxhimin e këtyre vlerave.

Pas viteve '90, ka ekzistuar një mungesë e theksuar koordinimi e bashkëveprimi midis institucioneve përgjegjëse që merrshin me grumbullimin dhe ruajtjen e burimeve gjenetike.

Mungesa e kuadrit ligjor dhe institucional, që do të përcaktonte qartë përgjegjësitë për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e burimeve gjenetike, bëri që të vazhdonte me ritme të shpejta, zhdukja e keqpërdorimi i burimeve gjenetike të bimëve.



Publikohet "lista e kuqe" e llojeve të rrezikuara me një numër prej 45.000 llojesh. Lista e Kuqe e publikuar nga IUCN është një rivlerësim i kësaj liste gjatë vitit 2008, duke shtuar në to lloje të tjera, të cilat gjenden të rrezikuara kudo në botë. Vizitoni <http://www.iucnredlist.org/> për listën e llojeve dhe informacione të tjera të dobishme mbi këtë temë.





Banka gjenetike e Shqipërisë pjesë e SESTO

■ Për herë të parë, Shqipëria bëhet pjesë e një sistemi bashkëkohor për dokumentimin e aksesioneve bimore. Sistemi quhet SESTO dhe ka kuptimin e Seed Storage (Ruajtjen e farave), por këtë herë në kuptimin elektronik. Ky sistem, që është instaluar dhe po personalizohet në bankën gjenetike, është marrë nga një nga partnerët e projektit SEEDNet, NGB (Nord Gene Bank). Ai ka më shumë se 14 vjet që funksionon dhe përmirësohet vazhdimisht nga specialistët e informatikës në Alnarp të Suedisë.

Projekti SEEDNet, në vazhden e punëve të kryera në kuadër të përmirësimit të organizimit të punës me grupet e kërkimit shkencor si dhe të kultivimit dhe rigjenerimit, ka ngritur edhe një grup pune për dokumentimin dhe përmirësimin e procedurave të punës nëpërmjet informatizimit. Grupi i punës së dokumentimit ka për detyrë:

- të hartojë strategjinë e informatizimit dhe dokumentimit për Bankën Gjenetike të Shqipërisë;
- Të studiojë e zbatojë teknologjitë e reja informatike për të përmirësuar punën në menaxhimin e burimeve gjenetike;
- Të mbështesë stafin e Bankës Gjenetike për dokumentimin e bazës së të dhënave.

Sistemi i ruajtjes së burimeve gjenetike

Ky grupi pune është tashmë aktiv që prej një viti specialistët e informacionit elektronik, z. Fabjan Lashi dhe z. Alban Ruci. Në kuadër të punës për ndërtimin dhe vënien në funksionim të këtij sistemi, janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për dokumentimin. Kështu, në fillim të vitit 2008, është hartuar dhe miratuar strategjia kombëtare e dokumentimit dhe ngritjes së databazës kombëtare

të ruajtjes dhe publikimit të dhënave. Menjëherë pas miratimit të strategjisë, u morën në shqyrtim disa mundësi për të ngritur sistemin elektronik të menaxhimit të punës në bankën gjenetike, si dhe bashkërendimi në shkëmbimin e të dhënave me qendrat e transferimit të teknologjisë nëpër rrethe.

Pas konsultimeve me ekspertë vendas e të huaj, u vendos që sistemi, që do të përdorej, të jetë i llojit “web-based”, pra duke përdorur teknologjinë e komunikimit me internet. Kjo zgjedhje u bë për lehtësitë që ofron ky protokoll komunikimi. Në çdo pikë që ka internet, punonjës, kërkues shkencorë, dhe vizitorë të interesuar kanë mundësi të konsultojnë të dhënat e veprimtarinë e bankës gjenetike dhe të ndërveprojnë me informacionin e publikuar apo për të publikuar vetë informacione në bazë të disa rregullave të paracaktuara.

Sistemi nuk është një “website” i thjeshtë, por një sistem i menaxhimit të punës, si mbledhja, pranimi, ruajtja, rigjenerimi e hapa të tjerë, që ndërmer bankë gjenetike, së bashku me partnerët vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Sistemi SESTO për nga pikëpamja e menaxhimit është i ndarë në dy pjesë: pjesa publike dhe pjesa e administrimit (Back Office)

Në këto dy pjesë, rregullat dhe të drejtat janë të kufizuara dhe të paracaktuara me kujdes. Cilido, që ndërvepron në këtë sistem, qoftë ai që hedh informacion, ashtu dhe ata që marrin informacion, regjistrohen automatikisht për aktivitetin e kryer në sistem. Kjo karakteristikë e sistemit i jep mundësi bankës të monitorojë dhe të nxjerrë statistika të rëndësishme nga sistemi funksional.

Ecuria

Aktualisht, është investuar nga partnerët e këtij projekti si FAO dhe Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, duke siguruar dy servera të teknologjisë së fundit për instalimin dhe funksionimin e sistemit, 6 kompjuterë për QTIB-të në rrethe, si dhe pajisje të tjera mbështetëse për funksionimin e këtij sistemi. Sistemi është instaluar në bashkëpunim me grupin shqiptar të punës dhe informaticienët e NGB-së, të cilët ndihmuan për instalimin dhe trajnimin e stafit shqiptar në bankën gjenetike në Tiranë. Trajnimi 3-ditor ishte në vijim të disa trajnimeve të tjera, me fokus shfrytëzimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e punës në dokumentimin e burimeve gjenetike. Të gjitha trajnimet dhe workshopet e organizuara kanë patur edhe informacion mbi rrjetin european të dokumentimit të burimeve EURISCO.

Në pjesën e dedikuar për EURISCO, ku Shqipëria, pas shumë viteve bashkëpunimi, dhe publikoi, për herë të parë, 504 aksesioneve të para në gusht 2008, janë diskutuar deskriptorët dhe mënyra e funksionimit të këtij rrjeti. Workshopi i fundit, i zhvilluar në dhjetor 2008, pati si folës Magdalena Svårdh, shefe e sektorit të dokumentimit të Nordgen, Sónia Dias koordinatorë e EURISCO dhe Lars Falk, shef i sektorit të IT në Nord Gen.



Pjesëmarrësit në trajnim - Foto A. Ibrahim

Burimet gjenetike bimore-pasuri kombëtare

Prof. As. Ndoc Faslia

Koordinator Kombëtar për Burimet Gjenetike

Sipas Konventës së Biodiversitetit (CBD), burimet gjenetike janë "Material gjenetik me vlera aktuale ose potenciale, që përfshijnë çdo material bimor apo shtazor dhe që përmbajnë njësi funksionale trashëgimie"

Të gjitha bimët, që janë përdorur në të kaluarën, që përdoren ende sot, ose që potencialisht, mund të përdoren, përfshirë dhe ato që mund të përdoren për qëllime seleksionimi, konsiderohen si burime gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin sa kohë që ato mund të shumëzohen.

Këto vlera paraqesin shumë rëndësi për bujqësinë dhe ushqimin, për luftën kundër varfërisë, për përmirësimin e mirëqenies së njerëzve, për sigurinë globale ushqimore, për një ushqim më të balancuar si dhe përbëjnë një element kyç për t'iu përgjigjur ndryshimeve drastike në ekosistemet botërore, për shkak të ndryshimeve klimatike.

Në Shqipëri, gjendja e menaxhimit të burimeve gjenetike nuk është e ndryshme nga menaxhimi i burimeve natyrore në përgjithësi. Sidoqoftë ka disa veçori që lidhen me gjendjen aktuale të kuadrin ligjor, institucional dhe praktikave të punës nga institucionet dhe aktorët e pëfshirë e të interesuar. Në këtë kuadër është më se e domosdoshme që koleksionet ex-situ të burimeve gjenetike bimore të plotësohen me popullatat e vendit, që mungojnë. Këto vlera gjenetike duhet të inventarizohen dhe vlerësohen në drejtim të rëndësisë për bujqësinë dhe ushqimin, sidomos i atyre aksesioneve që rrezikojnë të humbasin.

Kompjuterizimi dhe organizimi i këtyre të dhënave dhe informacioneve në formë të një baze të dhënash, lehtësisht të përdorshme nga të interesuarit. Për këtë proces bashkëpunimi mes Bankës Gjenetike dhe QTTB është me shumë rëndësi. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar është e nevojshme që të kryhet rifreskimi i të dhënave për Shqipërinë në EURISCO.

Llojet e rrezikuara për zhdukje, sidomos llojet spontane me rëndësi ekonomike për vendin, është e nevojshme që të ruhen in-situ, në kopshte të posaçme që mund të ngrihen në zonat përkatëse të vendit.

Natyrisht për të kryer sa më sipër është e nevojshme që të zhvillohen kapacitetet njerëzore, nëpërmjet trajnimeve dhe sidomos ndërgjegjësimit të komunitetit, duke bashkëpunuar me strukturat e shërbimit këshillimor.

Së fundi, duhet të theksojmë se promovimi i një bujqësie të qëndrueshme nëpërmjet diversifikimit të prodhimit bimor, sipas përkufizimit të FAO-s, ka si sfidë atë që:

"Ne duhet të plotësojmë nevojat për të tashmen, pa rrezikuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar ata nevojat e tyre".

Bashkëpunimi institucional, si çelës suksesi për ruajtjen e vlerave natyrore

Prof. Dr Tatjana DISHNICA

Drejtoresh e Shërbimit Këshillimor, Shkencës & Informacionit Bujqësor (MBUMK)

Lidhur me menaxhimin e Burimeve Gjenetike Bimore në Shqipëri janë vërejtur një sërë mangësish. Këto kanë të bëjnë me mungesa në kuadrin institucional (në përmirësim e sipër), nivel i ulët i ndërgjegjësimit i institucioneve dhe publikut për rëndësinë e burimeve gjenetike bimore, nivelin e kapaciteteve teknike, si dhe mungesën e rifreskimit të të dhënave për bimët.

Në kuadrin e Marrëveshjes Kuadër të Bashkëpunimit, ndërmjet MBUMK dhe UBT, nënshkruar në 25.02.2008, nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Jemin Gjani, dhe rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatos Harizaj, në datën 21.05.2008, u nënshkrua Marrëveshja për Menaxhimin e Burimeve Gjenetike Bimore, midis MBUMK dhe UBT. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, dy strukturat përkatëse, Drejtoria e Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Informacionit Bujqësor (MBUMK) dhe Banka Gjenetike (UBT) filluan punën për grumbullimin e të gjitha të dhënave për burimet gjenetike bimore, njihjen e gjendjes dhe kushteve të ruajtjes, si dhe përpunimin e përgatitjen e një baze të dhënash, për t'iu përdorur për ngritjen e rrjetit kombëtar dhe ndërkombëtar të informatizimit të burimeve gjenetike.

Krijimi i 5 QTTB, në zonat kryesore agro klimatike të vendit, që ka në fokus reformimin dhe orientimin më të mirë të kërkimit bujqësor ndaj kërkesave të tregut dhe prioritetëve rajonale, në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm, detyrimisht do të shoqërohet edhe me një ripozicionim të ri të këtyre strukturave të reja, ndaj kërkimit bujqësor dhe mësimdhënies në Universitet.

Aktualisht në Shqipëri ka disa institucione që merren me resurset gjenetike të bimëve si: i) MBUMK me Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore të shpërndara në 5 zonat me kryesore agro klimatike në vend; ii) Universiteti Bujqësor i Tiranës me Departamentin e Bujqësisë, Seksionin e gjenetikës së bimëve dhe Bankën Gjenetike Kombëtare; dhe, iii) Ministria e Mjedisit që ka në varësi zonat e mbrojtura të vendit.

MBUMK dhe UBT, në vijim të marrëveshjeve të nënshkruara po bashkëpunojnë ngushtë, për zbatimin e projekteve që fokusohen në përmirësimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve gjenetike bimore për bujqësinë e ushqimin në Shqipëri si dhe në krijimin e një rrjeti për RGJB.

Aktivite të Projektit SEEDNet (2008)

Prill 2008

Shqipëria bëhet vendi pritës i takimit të tetë të Komitetit Drejtues Rajonal (RSC) të projektit SEEDNet. Ky ishte takimi i parë për fazën e dytë të projektit SEEDNet në rajonin e Evropës Juglindore. Gjatë këtij takimit të RSC, u zgjodh edhe grupi drejtues i RSC për fazën e dytë.

Maj 2008

Universiteti Bujqësori i Tiranës në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me mbështetjen e projektit SEEDNet, organizuan seminarin Kombëtar me temë "Ruajtja e burimeve gjenetike të bimëve në Shqipëri, problemet dhe objektivat për të ardhmen". Seminari u organizua nga projekti SEEDNet, Drejtoria e Shërbimit Këshillimor dhe Shkencës dhe Banka Gjenetike, me qëllim konkretizimin e një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve në fushën e burimeve gjenetike. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje, përcaktoi rolin Koordinues të Bankës Gjenetike në fushën e burimeve gjenetike të bimëve.

Qershor – Korrik 2008

Ngrihet grupi i përbashkët i punës ndërmjet Bankës Gjenetike dhe Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), me specialistë me përvojë të gjatë në këtë fushë. Në fund të korrikut 2008 përfundoi procesi i inventarizimit të përgjithshëm të aksesioneve që janë në ruajtje në Bankën Gjenetike dhe në QTTB-të.

Korrik – Shtator 2008

Me mbështetjen e projektit SEEDNet dhe me bashkëpunim të Bankës Gjenetike dhe Drejtorisë së Shkencës në Ministrinë e Bujqësisë, u ngritën grupet e përhershme të punës për dokumentimin dhe burimet gjenetike të bimëve.

Gusht 2008

Departamenti i Shkencës në Ministrinë e Bujqësisë ofron mbështetje për zyrat lokale të ekstensionit në bujqësi për aktivitetet e "on farm conservation" të projekti SeedNet.

Shtator 2008

Dërgohen në EURISCO të dhënat e para nga Shqipëria për 504 aksesione të para për Inventarin Kombëtar të Shqipërisë. Kjo e bën Shqipërinë të pranishme, për herë të parë, në një Bankë të rëndësishme, ku gjendet 36 inventaret kombëtare të 36 vendeve të Evropës.

Tetor 2008

Kordinatori Kombëtar dhe Zv. Kordinatorit i SEEDNet marrin pjesë në RSC-në e nëntë të projektit, zhvilluar në Bukuresht, Rumani. Në këtë takim, pala shqiptare paraqiti objektivat e saj për fazën e dytë të zbatimit të projektit SEEDNet për vitin 2008.

Nëntor 2008

Seminar Kombëtar për trajtimin e burimeve gjenetike të drufrutorëve. Në të u dhanë mendime e propozime konkrete mbi programin kombëtar për eksplorimin, koleksionimin, vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve gjenetike.

Dhjetor 2008

Shqipëria dërgon në EURISCO të dhënat e dyta të korrigjuara dhe të plotësuara për 1146 aksesione për Inventarin Kombëtar të Shqipërisë.

Dhjetor 2008

IT - Workshop për dokumentimin e Burimeve Gjenetike të Bimëve në Shqipëri. Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që zbaton këtë sistem dokumentimi (SESTO) në Bankën Gjenetike të saj. Për këtë aktivitet, projekti SeedNet ka siguruar mbështetje nga Nord Gen Bank dhe Bioversity International, dy organizmat më të rëndësishme të Evropës, që menaxhojnë programet elektronike SESTO dhe EURISCO.

Dhjetor 2008

Seminar Kombëtar me temë: "Menaxhimi i Burimeve Gjenetike të drithërave në vendin tonë". Në kuadër të projektit SEEDNet dhe marrëveshjes midis Qendrës së Biodiversitetit të Suedisë (Swedish Centre-CMB) me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Banka Gjenetike, në bashkëpunim me Grupin e punës së Drithërave dhe Misrit, të Projektit SEEDNet, zhvilloi Seminarin Kombëtar "Menaxhimi i Burimeve Gjenetike të Drithërave në vendin tonë".

Bashkëpunimi me aktorë potencialë jo qeveritarë

Gusht 2008

Koordinatori i SeedNet nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën BioAdria, në fushën e ruajtjes të Burimeve Gjenetike vendase dhe rrugët e mundshme të ruajtjes, inventarizimit, vlerësimit të tyre.

Në bazë të kësaj marrëveshje BioAdria dhe projekti SeedNet për Shqipërinë do të organizojnë së bashku seminare ndërgjegjësuese për fermerët në zona të ndryshme të Shqipërisë. BioAdria vë në funksion të projektit SeedNet rrjetin e saj me institucionet brenda dhe jashtë vendit.

Shtator 2008

UBT nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC) Shqipëri. Qëllimi i kësaj marrëveshje është realizimi i një bashkëpunimi mbi aktivitetet dhe veprimtarinë që kryen projekti SeedNet në Shqipëri për ndërgjegjësimin në fushën e Burimeve Gjenetike të Bimëve, duke i ofruar projektit SeedNet komunikimin elektronik të REC (www.mjedisistot.info dhe revistën Mjedi Sot).

Bashkëpunimi rajonal

Për të fuqizuar dhe për të rritur efikasitetin e punës dhe njëkohësisht për të rritur shkallën e ndërgjegjësimin të ruajtjes së burimeve gjenetike në rajon, projekti SeedNet financon çdo vit edhe projekte të përbashkëta rajonale, me pjesëmarrjen e çdo vendi partner të rrjetit SeedNet.

Projekti SEEDNet

Programi SEEDNet (South East European Development Network on Plant Genetic Resources) i ka fillësat e tij në vitin 2004. Ai u ngrit me idenë e krijimit të një rrjeti bashkëpunimi rajonal në fushën e ruajtjes së burimeve gjenetike bimore në Europën Juglindore (SEEDNet).

Banka Gjenetike e Shqipërisë, që është pjese integrale e UBT, është aktualisht institucioni përgjegjës dhe përfitues i Projektit SEEDNet, financuar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA), me koordinator të projektit, Qendrën e Biodiversitetit të Suedisë (CBM).

Partnerët e projektit

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri
2. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave e Bosnjë-Hercegovinës;
3. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave e Republikës Serbe, të Bosnjës;
4. Instituti i Bujqësisë, Shkup, Maqedoni;
5. Instituti për Burimet Gjenetike Bimore, (IPGR), Sadovo, Bullgari
6. Instituti për Farat dhe Fidanët, Osijek, Kroacia;
7. Qendra për Burimet Gjenetike të Bimëve, Akademia e Shkencave të Moldavisë;
8. Instituti Bioteknik, Podgoricë, Mali i Zi;
9. Universiteti i Prishtinës, Kosovë;
10. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, Departamenti i Burimeve Gjenetike dhe OMGJ, Beograd, Serbi;
11. Banka Gjenetike Kombëtare, Suceava, Rumani;
12. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ushqimit, Ljubljana, Slloveni.

Ky projekt është financuar nga SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), CBM (Qendra Suedeze e Biodiversitetit) është agjencia zbatuese e projektit.

Çfarë synon programi SEEDNet?

Të kontribuojë në ndërtimin dhe fuqizimin e programit kombëtar në burimet gjenetike të bimëve (PGR), me qëllim që të sigurojë ruajtjen e këtyre burimeve në të gjithë rajonin.

- Të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve;
- Të forcojë bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe krijimin e lidhjeve midis institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, që merren me burimet gjenetike të bimëve, nëpërmjet grumbullimit të tyre përdorimit të kësaj pasurie nga institucione të ndryshme kërkimore shkencore që mund të shprehin interes për to.
- Pjesë e rëndësishme e këtij rrjeti të ri është dhe ngritja e bazave të të dhënave kombëtare me

pjesët lokale të saj, që do të funksionojë si pjesë integrale e rrjetit rajonal të bankave gjenetike, gjithashtu pjesë përbërëse e sistemit SESTO të Nordic Gene Bank (NGB) dhe rrjeteve të tjera si EPIGRIS, etj.

Objektivat specifikë

- Të ndërtojë programet kombëtare të burimeve gjenetike të bimëve (PGR);
- Të hartojë standardet dhe të përmirësojë kushtet për ruajtjen e burimeve gjenetike të bimëve
- Të kryejë inventarizimin kombëtar të burimet gjenetike të bimëve;
- Të dokumentojë dhe të informatizojë burimeve gjenetike të bimëve në rajon;
- Të hartojë strategjitë për ruajtjen dhe të mbështesë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të ndërtojë rrjetet kombëtare dhe rajonale për burimeve gjenetike të bimëve;
- Të krijojë një forum rajonal për shkëmbimin e njohurive, përvojën dhe informacionin mbi burimet gjenetike të bimëve;
- Të krijojë një rrjet aktivitetesh dhe projektesh për ruajtjen dhe përdorimin dypalësh.

Për Shqipërinë, projekti synon krijimin e një rrjeti kombëtar për burimet gjenetike të bimëve, duke përfshirë në të, gjithë institucionet përgjegjëse në vend që merren me burimet gjenetike të bimëve dhe, njëkohësisht, duke ftuar në këtë nismë të gjithë specialistët e fushës për një kontribut të përbashkët për burimet gjenetike të bimëve në Shqipëri.

Partnerët e SEEDNet duhet të ofrojnë ekspertë, të cilët duhet të sigurojnë ekspertizën e nevojshme profesionale në grupet e punës. Grupet e punës janë të hapur për 1 pjesëmarrës për çdo partner në rrjetin rajonal të SEEDNet.

Grupet e punës në projektin SEEDNet në Shqipëri dhe në rajon janë:

- Drithrat dhe Misri
- Bimët Mjekësore dhe Aromatike
- Perimet
- Drufrutorët dhe hardhitë
- Bimët Foragjere
- Bimët Industriale
- Grupi i teknologjisë së Informacionit dhe dokumentimit

Dr. Alban Ibraliu

**Koordinatori Kombëtar i Projektit SEEDNet
Universiteti Bujqësor i Tiranës.**



PROJEKTE MJEDISORE ME NISMA VENDORE

Zhvillimi i kapaciteteve

Njoftimi për Trajnim

Qendra Rajonale e Mjedisit, në kuadër të komponentit për zhvillimin e kapaciteteve të Programit “Projekte Mjedisore me Nisma Vendore - Fondi Special Holandez 2”, do të organizojë në datat 22-23 Janar 2008, trajnimin me temë “Mbrojtja dhe rritja e shkallës së biodiversitetit në zonat urbane”.

Në trajnim janë të ftuar të marrin pjesë përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe të strukturave të qeverisjes vendore, që janë të interesuar për të aplikuar me projekt propozime në kuadër të këtij programi. OJF juaj duhet të sigurojë dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesit të njësisë së qeverisjes vendore në trajnim.

REC mbulon shpenzimet e nevojshme që lidhen me pjesëmarrjen e personave në trajnim (dieta, udhëtim dhe akomodim) për ata që do të udhëtojnë në Tiranë. Sidoqoftë për më shumë detaje që lidhen me logjistikën do të kontaktojmë në një moment të dytë me pjesëmarrësit e përzgjedhur.

Meqenëse pjesëmarrja në trajnim është e kufizuar, të interesuarit duhet që të konfirmojnë pjesëmarrjen në trajnim sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda datës 9 Janar 2008, duke dërguar emrat dhe kontaktet e personave që kërkojnë të marrin pjesë në trajnim në këto kontakte:
faks: (04) 223-2928; e-mail: grants@albania.rec.org

Lista e aplikantëve do të shqyrtohet nga REC dhe pjesëmarrësit e përzgjedhur do të kontaktohen drejtpërsëdrejti nga REC për detajet e organizimit dhe programin e trajnimit

Për më shumë informacion në lidhje me kalendarin e trajnimeve, vendin e zhvillimit dhe programet e tyre, kontaktoni me Zyrën e REC në Shqipëri

*Për më shumë rreth programit dhe këtij aktiviteti vizitoni:
<http://albania.rec.org>*

Fitorja e Obama-s shënon rilindjen e politikës amerikane për mjedisin



Presidenti i ri amerikan, Obama, do të hedhë poshtë politikën e administratës Bush për energjinë dhe do të prezantojë një projektligj të ri për ndryshimet klimatike në përpjekje për të përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rrjetin ndërkombëtar mjedisor.

Obama, në një fjalim të tijin, e ka quajtur planetin “në rrezik” duke iu referuar qartë ndryshimeve klimatike. Në planet e tij më të afërta është dërgimi i një grupi përfaqësuesish për energjinë në bisedimet e Kombeve të Bashkuara për klimën, që do të zhvillohen në Poznam, të Polonisë.

Gjithashtu, pritet që Obama të shpallë një objektiv për reduktimin e shkarkimeve të gazrave serë në Amerikë në nivelet e vitit 1990-të, kjo deri në 2020-ën, dhe më pas në reduktimin e tyre me 80% deri në 2050-ën. Kjo do të arrihet nëpërmjet një sistemi kapje-tregtimi i gazrave serë dhe nxjerrjen në ankand të lejeve për karbonin, cka do të nxisë industrinë të reduktojë shkarkimet e tyre.

Kjo nismë do të konkurojë me ambicet e Britanisë së Madhe për reduktimin me 80% deri në 2050-ën, ndërkohë që do tejkalojë objektivin e Evropës e angazhuar për reduktimin me 60% të gazrave serë në të njëjtën kohë.

Rezultatet e zgjedhjeve amerikane janë mirëpritur nga grupet mjedisore amerikane. Rodger Schlickeisen, president i “Fondit për Veprim të

Mbrojtësve të Jetës së Egër Natyrore”, u shpreh se “Për herë të parë gjatë një dekade, ne mund të shohim të ardhmen me një ndjenjë shprese se sfidat e mëdha mjedisore me të cilat po përballemi tashmë do të marrin drejtim dhe se ajri, toka, uji dhe jeta e egër, si dhe i gjithë planeti ynë, nuk do të sakrifkohen më për të plotësuar kërkesat e industrive ndotëse.”

“Është e vështirë të përshkruhet dëmet e shkaktuara nga keqdrejtimi i administratës Bush dhe politikat e ndjekura për mjedisin. Për tetë vjet, kanë mbizotëruar interesa të vecanta, duke diktuar virtualisht politikat tona për ruajtjen e mjedisit dhe energjinë”.

Gjithashtu, grupet mjedisore e konsiderojnë fitoren e Obamës si një drejtim të ri dhe radikal të politikave mjedisore amerikane. “Fitorja e Obamës do t’i japë bisedimeve kritike për klimën një shans më të madh suksesi, Shtetet e Bashkuara duhet të marrin përsipër përgjegjësitë e veta ndërkombëtare, duke qenë leadership pozitiv në zhvillimin ekonomik të globit me nivele të ulta karboni”, u shpreh Andy Atkins, drejtor ekzekutiv i grupit “Miqte e Tokës” në Londër.

Gjithësesi, kriza globale financiare mund të rrezikojë shumë nga planet e tij, paralajmërojnë disa analistë, kur pritet që shumë kompani që përdorin teknologji të pastra të mbyllin veprimtarinë e tyre në muajt e ardhshëm.

John Vidal
www.guardian.co.uk

Reduktimi i shkarkimeve të gazrave serë me 80% deri në 2050-ën

1. Zbatimi i një programi mbarë ekonomik për kapjen dhe tregtimin e karbonit, me qëllim reduktimin e shkarkimeve të gazrave serë me 80% deri në 2050-ën. Politikat e dyshes Obama-Biden për kapjen dhe tregtimin e karbonit kërkon nxjerrjen në ankand të krediteve ndotëse, ndërkohë që të ardhurat do të shkojnë për investime për energji të pastër në të ardhmen, për mbrojtjen e habitateve, si dhe asistencë e mbështetje financiare për familjet.
2. Shndërrimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lider të ndryshimeve klimatike. Obama dhe Biden do të ripërfshihen në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, forumi më i madh ndërkombëtar kushtuar problemeve të klimës. Gjithashtu, ata do të krijojnë një Forum Global për Energjinë me pjesëmarrjen e shkarkuesve më të mëdhenj të botës, me qëllim fokusimin kryesor te energjia në mbarë globin dhe çështjet mjedisore.

marrë nga programi politik i Presidentit të zgjedhur të SHBA, Barack Obama

Krijohet një Agjenci Ndërkombëtare për Energjinë e Ripërtërishme (IRENA)

■ Ajo çka diskutohej më parë, tashmë është drejt realizimit konkret: 51 shtete nga mbarë bota kanë rënë dakort mbi Statutin (Marrëveshjen) e Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë e Ripërtërishme (IRENA) gjatë Konferencës Finale Përgatitore të mbajtur në 23 – 24 Tetor 2008, në Madrid të Spanjës.

Faza finale në procesin e themelimit të IRENAs – Konferenca e Themelimit – është programuar të zhvillohet në 26 Janar 2009, në Bon të Gjermanisë. Në këtë Konferencë do të firmoset Statuti i Agjencisë, dhe në këtë mënyrë do të themelohet IRENA.

Duke marrë në konsideratë madhësinë dhe urgjencën e detyrave me të cilat IRENA do të përballet, shumë prej shteteve ranë dakort që Agjencia të fillojë të funksionojë dhe të krijojë një strukturë pune efektive menjëherë pas themelimit të saj.

Përsheptimi i miratimit dhe përdorimi i qëndrueshëm i energjisë së ripërtërishme me një potencial të madh

Energjia e ripërtërishme është një nga zgjidhjet kyçe të sfidave më të fundit me të cilat po përballet e ardhmja e energjisë në botë. Gjermania, gjatë dekadës së fundit, ka zbatuar një politikë ambicioze për energjinë e ripërtërishme, duke promovuar me sukses energjitë e ripërtërishme në nivel kombëtar dhe brenda Bashkimit Europian. Shumë shtete tashmë kujdesen për prodhimin dhe përdorimin e energjisë së ripërtërishme përmes rrugëve të ndryshme në nivel politik dhe ekonomik, pasi tashmë ata pranojnë nevojën urgjente të ndryshimit të rrugës së ndjekur deri më tani nga energjia. Përdorimi aktual i energjisë së ripërtërishme, megjithatë, është ende i kufizuar, pavarësisht potencialeve të mëdha të saj, ndërkohë që pengesat janë shumëfishuar.

Një pamje e re e ndryshimeve klimatike nga Google Earth

■ Miliona përdorues të Google Earth në mbarë botën do të mund të shohin se si ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në planetin Tokë dhe te banorët e tij përgjatë shekullit të ardhshëm, krahas pamjeve të humbjes së shtresës së akullit në Antarktik gjatë 50 vjetëve të fundit, kjo falë një projekti të ri lancuar së fundmi.

Projekti “Ndryshimet Klimatike në Botën Tonë” është produkt i një bashkëpunimi midis Google, Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, Qendrës ‘Met Office Hadley’ dhe Studimit Britanik për Antarktikën, dhe synon të sigurojë dy ‘shtresa’ të reja, ose animacione, të vlefshme për të gjithë përdoruesit e Google Earth.

Një prej animacioneve tregon temperaturat e botës gjatë njëqind vjetëve nën ndikimin e rritjes mesatare të shkarkimeve të gazit serë, së bashku me historitë se si njerëzit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në disa prej vendeve më të varfëra të botës janë tashmë të prekur nga sistemi i ndryshimeve klimatike.

Përdoruesit, gjithashtu, mund të marrin informacionin mbi veprimet që ata mund të ndërmarrin individualisht, në komunitet, nga bizneset dhe qeveritë për të përballuar ndryshimet klimatike.

Animacioni tjetër, i zhvilluar nga Studimi Britanik për Antarktikën, tregon tërheqjen e masave të akullit që prej vitit 1950.

Projekti, aktualisht, është një pamje e informacioneve më të fundit shkencore për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre. Partnerët në këtë projekt do të përpiqen të zhvillojnë më tej këto ide në të ardhmen, së bashku me partnerë të tjerë.





mbillni një pemë sot...

...për fëmijët tuaj nesër!